

AKT THEMELIMI
“RRJETA.AL” Sh.p.k.

Tiranë më, 07 / 03 / 2022

Ortakët e Shoqërisë “RRJETA.AL” Sh.p.k. bëjnë hatrimin e Aktit të Themelimit të kësaj Shoqërie të cilët, bazuar, në legjislacionin në fuqi veçanerisht, ligjit nr. 9901 dt.14.04.2008 «Për Shoqëritë Tregtare » i ndryshuar, Ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, LIGJ Nr. 131/2015 PËR QENDRËN KOMBËTARE TË BIZNESIT, në dispozitat e Kodit Civil si dhe me vullnetin e lirë të shprehur ranë dakort dhe nënshkruan aktet e themelimit të shoqërisë me termat në vijim:

Neni 1

Bazuar në vullnetin e plotë dhe të lirë të palëve dhe në vendimin e marrë në mbledhjen për krijimin e shoqërisë, kjo kontratë hartohet midis:

1. **Znj. Lumturi SHEHAJ**, e bija e Hysenit, e datëlindjes 25 Qershor 1979, lindur në Tepelenë dhe banuese në Tiranë, e identifikuar me Kartën e Identitetit me Nr. **035502602** dhe Nr. **Personal H95625030G**.
2. **Z. Klodian ISLAMI**, i biri i Aliut, i datëlindjes 24 Shtator 1978, lindur në Tepelenë dhe banues në Tiranë, i identifikuar me Kartën e Identitetit me Nr. **037647578** dhe Nr. **Personal H80924051V**.
3. **Z. Ervin SHEHAJ**, i biri i Mystehakut, i datëlindjes 9 Shtator 1980, lindur në Fier dhe banues në Tiranë, i identifikuar me Kartën e Identitetit me Nr. **035541618** dhe Nr. **Personal I00909113C**.
4. **Z. Flogert MUÇA**, i biri i Abdullait, i datëlindjes 14 Shtator 1991, lindur në Shkallë, Mat dhe banues në Tiranë, i identifikuar me Pasaportën me Nr. **BB5953022** dhe Nr. **Personal J10914008K**
5. **Z. Rrahim JATA**, i biri i Abdylit, i datëlindjes 25 Shkurt 1996, lindur në Bushtricë dhe banues në Tiranë, i identifikuar me Pasaportën me Nr. **BC4946671** dhe Nr. **Personal J602250430**

Neni 2

Të gjithë ortakët marrin pjesë personalisht në mbledhjen e themelimit të kësaj shoqërie.

Në mbledhjet e tjera të ortakëve, secili ortak ka të drejtën të përfaqësohet nga persona të tjerë apo avokatë të pajisur me prokurë noteriale dhe kanë të drejtë ti revokojnë ata.

Neni 3


Shoqëria është person juridik dhe aktiviteti i saj do të rregullohet në bazë dhe për zbatim të dispozitave që parashikohen në statut dhe në legjislacionin bazë “Për Shoqëritë Tregtare” të Republikës së Shqipërisë.

Neni 4

Shoqëria do ta zhvillojë aktivitetin e saj tregtar për një periudhë kohe të pa kufizuar.

Kjo Shoqëri nuk do të shpërndalet, me përjashtim të rasteve që përcaktohen në statut dhe të rasteve të tjera të parashikuara shprehimisht në ligj, ose nga forca madhore, gjendje lufte etj.

Neni 5



Emërtimi I kësaj shoqërie me përgjegjësi të kufizuar u vendos në mbledhjen e parë të Asamblesë së Ortakëve dhe u quajt **“RRJETA.AL”** Sh.p.k. Shoqëria do të ketë vulën e saj me mbishkrimin **“RRJETA.AL”** Sh.p.k.

Neni 6

Selia e shoqërisë do të jetë në qytetin e Tiranës, “Rruga Haxhi Kika, Kompleksi Niku, Shk. 2, Tiranë, Shqipëri”.

Por aktiviteti i saj tregëtar do të shtrihet edhe në rrethe të tjera, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, si dhe mund të hapi filiale ose përfaqësi në këto vende.

Neni 7

Kjo Shoqëri e zhvillon veprimtarinë e saj privat në mënyrë private të pavarur dhe përgjigjet eskuzivisht vetëm me kapitalin e saj. Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet që rrjedhin nga veprimtaria private që zhvillojnë ortakët e saj jashtë kuadrit të marrëveshjes së kësaj Shoqërie.

Neni 8

Kapitali fillestar i themelimit të Shoqërisë do të jetë 100.000 (Njëqind mijë) Lekë.

Neni 9

Kapitali themelor i Shoqërisë është vendosur nga të 5 (pesë) ortakët si më poshtë:


1. **Znj. Lumturi SHEHAJ**, e bija e Hysenit, e datëlindjes 25 Qershor 1979, lindur në Tepelenë dhe banuese në Tiranë, e identifikuar me Kartën e Identitetit me **Nr. 035502602 dhe Nr. Personal H95625030G**, ka 1 (një) kuotë dhe ka vendosur shumën 20.000 (Njëzet mijë) lekë, që përfaqëson 20% të kapitalit themeltar.
2. **Z. Klodian ISLAMI**, i biri i Aliut, i datëlindjes 24 Shtator 1978, lindur në Tepelenë dhe banues në Tiranë, i identifikuar me Kartën e Identitetit me **Nr. 037647578 dhe Nr. Personal H80924051V**, ka 1 (një) kuotë dhe ka vendosur shumën 20.000 (Njëzet mijë) lekë, që përfaqëson 20% të kapitalit themeltar.
3. **Z. Ervin SHEHAJ**, i biri i Mystehakut, i datëlindjes 9 Shtator 1980, lindur në Fier dhe banues në Tiranë, i identifikuar me Kartën e Identitetit me **Nr. 035541618 dhe Nr. Personal I00909113C**, ka 1 (një) kuotë dhe ka vendosur shumën 20.000 (Njëzet mijë) lekë, që përfaqëson 20% të kapitalit themeltar.
4. **Z. Flogert MUÇA**, i biri i Abdullait, i datëlindjes 14 Shtator 1991, lindur në Shkallë, Mat dhe banues në Tiranë, i identifikuar me Pasaportën me **Nr. BB5953022 dhe Nr. Personal J10914008K**, ka 1 (një) kuotë dhe ka vendosur shumën 20.000 (Njëzet mijë) lekë, që përfaqëson 20% të kapitalit themeltar.
5. **Z. Rrahim JATA**, i biri i Abdylit, i datëlindjes 25 Shkurt 1996, lindur në Bushtricë dhe banues në Tiranë, i identifikuar me Pasaportën me **Nr. BC4946671 dhe Nr. Personal J60225043O**, ka 1 (një) kuotë dhe ka vendosur shumën 20.000 (Njëzet mijë) lekë, që përfaqëson 20% të kapitalit themeltar.

Neni 10

Kuotat e vendosura nga secili ortak do të derdhen në Bankën “BKT”.

Pjesa tjetër e kapitalit të Shoqërisë do të përbëhet në para ose valutë të konvertueshme, ose në kapital në natyrë, si dhe në mjetet e xhiros të veprimtarisë së këtij personi juridik.

Neni 11



2

Shoqëria do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj private:

Shërbime IT, Zhvillim dhe Shitje/Blerje, Mirëmbajtje Platformash dhe Aplikacionesh Software, Shërbime Profesionale për Biznesin, Marketing Online, Shitblerje Online, Shërbime Konsulence, Studime Tregu, PR, Ndërmjetësime.

Neni 12

Veprimtaria private tregtare e shoqërisë mbrohet nga Shteti Shqiptar dhe nga legjislacioni i Republikës së Shqipërisë.

Neni 13

Ortakët apo përfaqësuesit e tyre ligjor janë të detyruar të ruajnë sekretet e shoqërisë. Shkalla e këtyre sekreteve dhe rregullorja për ruajtjen e tyre përcaktohet në mbledhjen e Asamblesë së Ortakëve dhe janë të detyrueshme të zbatohen nga secili person i punësuar në Shoqëri. Çdo veprim që është në kundërshtim me sa më sipër, do të përbëjë një shkelje të disiplinës dhe të ligjit.

Neni 14

Fitimi neto që do të shpërndahet proporcionalisht midis ortakëve sipas përqindjeve të përcaktuara gjatë krijimit të kapitalit.

Neni 15

Organet drejtuese të Shoqërisë "**RRJETA.AL**" Sh.p.k. janë Asambleja e Ortakëve ose përfaqësuesit ligjor të tyre të pajisur me prokurë të posaçme dhe Administratori i Shoqërisë "**RRJETA.AL**" Sh.p.k.

Neni 16

Asambleja e Ortakëve ka vendosur që Administratori i shoqërisë të jetë **Z. Ervin SHEHAJ**. Administratori i Shoqërisë ka një mandat 5 (Pesë) Vjeçar.


Neni 17

Të drejtat dhe përgjegjësitë e ortakëve si dhe kompetencat e organeve drejtuese jepen në detaje në Statutin e Shoqërisë.

Neni 18

Organet vendimmarrëse të Shoqërisë "**RRJETA.AL**" Sh.p.k. krahas të drejtave dhe detyrimeve të përcaktuara në këtë kontratë dhe në Statutin e Shoqërisë në marrëdhënie në palët e treta do të përfaqësohen nga Administratori, i cili ka të drejtë emërojë persona të tjerë me prokurë speciale, duke ruajtur të drejtën e revokimit të tij.

Neni 19



Kontrolli i aktivitetit financiar të Shoqërisë do të bëhet nga Asambleja e Ortakëve sipas përcaktimeve të bëra në Statutin e Shoqërisë.

Neni 20

Për nevojat e zhvillimit të veprimtarisë financiare dhe ekonomike të shoqërisë, kjo mund të angazhojë njerëz të tjerë apo ekspertë me miratimin e Administratorit, në bazë të strukturës së miratuar nga Ortakët.

Marrëdhëniet e punës me punonjësit e Shoqërisë do të rregullohen me kontrata të veçanta pune. Për çështjet që nuk do të jenë shprehur në kontratë, do të merret për bazë Kodi i Punës në Shqipëri apo i vendit ku do të veprojë Filiali i Shoqërisë.

Neni 21

Secili punonjës i angazhuar nga shoqëria është përgjegjës individualisht apo kolektivisht karshi ligjit. Në këtë drejtim, çdo punonjës që i shkakton dëm Shoqërisë apo dhunon kontratën dhe Statutin, do të jetë përgjegjës ndaj autoriteteve juridike në vendin ku është shkaktuar dëmi.

Neni 22

Niveli i pagave do të përcaktohet mbi bazën e nivelit profesional të punonjësit dhe punës konkrete që ai kryen.

Neni 23

Shpenzimet që do të bëhen nga Ortakët si dhe shpenzimet e tjera që do të bëhen nga punonjësit brenda dhe jashtë vendit për nevojat e Shoqërisë, do të mbulohen nga kjo e fundit. Shuma e pagesave për udhëtim, shkëmbim, eksperiencë, asistencë teknike dhe veprimtari të tjera, do të përcaktohen nga Asambleja e Ortakëve


Neni 24

Shoqëria "**RRJETA.AL**" Sh.p.k. mund të bashkohet, të ndahet dhe të lidhet me shoqëri të tjera apo me filialet e tyre, me persona fizik dhe juridik, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të veçantë të Asamblesë së Ortakëve apo përfaqësuesit e tyre.

Neni 25

Secili Ortak ka të drejtë të rrisë apo të pakësojë kuotat e tij të kapitalit në Shoqëri, me miratimin paraprak të Ortakëve të tjerë.

Neni 26



Përfundimi i likujdimit të Shoqërisë "RRJETA.AL" Sh.p.k me përjashtim të rasteve të parashikuara në këtë kontratë dhe Statut, do të vendoset nga Asambleja e Ortakëve dhe sipas Legjislacionit Shqiptar.

Likujdimi i Shoqërisë do të kryhet në përputhje me rregullat e përcaktuara në Statut dhe në ligjin që rregullon veprimtarinë e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar.

Asambleja e Ortakëve, apo përfaqësuesit e tyre ligjor, emërojnë komisionin e likujdimit të kësaj Shoqërie, e cila përfaqëson bilancin e pagesave. Mbas kësaj vendos Asambleja e Ortakëve për përfundimin e veprimtarisë së kësaj Shoqërie.

Neni 27

Çdo veprim që vjen në kundërshtim me dispozitat e Statutit dhe Aktin e Themelimit, nuk është i vlefshëm dhe nuk ka pasoja juridike për shoqërinë.

Neni 28

Shoqëria "RRJETA.AL" Sh.p.k fillon veprimtarinë e saj si person juridik me rregjistrimin e saj në regjistrin tregtar në QKB, duke fituar të drejtën dhe detyrimet ndaj palëve të treta në përputhje dhe në zbatim të Legjislacionit Shqiptar në fuqi.

Neni 29

Kontrata e Ortakëve hyn në fuqi mbasi "RRJETA.AL" Sh.p.k. të jetë rregjistruar në QKB Tiranë.

ORTAKET

Znj. Lumturi SHEHAJ

Lumturi Shehaj

Z. Klodian ISLAMI

Klodian Islami

Z. Ervin SHEHAJ

ERVIN SHEHAJ

Z. Flogert MUÇA

Flogert Mucë

Z. Rrahim JATA

Rrahim Jata